



**MIMI
MEMIAJ**

Nga Ideja te Suksesesi me Albania Craftsman Education (ACE)

Mimi, një vajzë e lindur dhe rritur në Tiranë, pas vitit 1995 përfundoi studimet pasuniversitare për ekonomi-financë. Gjatë vitit 2004-2007 studioi në Akademinë Milano Fashion Campus në Itali për Fashion dhe Art Design, master në Universitetin RMT për "Business Planning for Success".

Mimi kishte nevojë për mbështetje serioze për të zhvilluar idetë e saj për themelimin e një shkolle, që sot mban emrin Albania Craftsman Education, ACE. RisiAlbania bashkëpunon ngushtësisht me Mimin që nga dita e themelimit të shkollës në vitin 2020 dhe në vazhdim. Fokusi i kësaj shkolle dhe suporti që RisiAlbania i ka dhënë është: përfshirja e grupeve të marginalizuara (gratë, të kthyerit, të rinjtë me arsim të ulët dhe të papunët) jashtë kryeqytetit dhe ofrimi i mundësive të punësimit dhe vetëpunësimit për gratë dhe të rinjtë që jetojnë në zona të largëta; mbajtja gjallë e traditës, vlerësimi i trashëgimisë së familjeve dhe kulturës në mënyrë profesionale dhe inovative si dhe mobilizimi i grave dhe të rinjve në disavantazh nëpërmjet kurseve online dhe fizike.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



HELVETAS
ALBANIA



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

"Me RisiAlbania jam në partneritet të ngushtë bashkëpunimi, besueshmërie në përputhje me realizimin dhe kërkesat që RisiAlbania sjell përherë dhe më novatore dhe kjo marrëdhënie bashkëpunimi do të funksionojë në vite dhe në mbështetje të çdo iniciative dhe risie që do të ndërmerren në projektet e tyre", tregon Mimi.

Sipas saj, falë këtyre bashkëpunimeve, janë sjellë me qindra histori suksesi në rang vendi.

"Normalisht sukseset e tyre janë një bonus për ta identifikuar ACE një histori suksesi për RisiAlbania. Ata na besuan dhe bashkëpunuan ngushtë në ecurinë dhe misionin që ACE ndërmoi që në ditën e parë dhe shifrat treguan vetëm rritje dhe përgjegjësi mbi çdo ide dhe objektiv të saj ndër vite".

Shkolla e artizanit shqiptar "Albania Craftsman Education" (ACE) është një Qendër e Inovacionit Strategjik, ku ndërthuren edukimi profesional, zëjt dhe zanatet e trashëguara, artet kontemporane dhe digjitale, në kurse afatshkurtra online dhe offline. Shkolla është një auditor rinor gjithëpërfshirës, ku frekuentuesit e saj janë të interesuar jo vetëm për kurset dhe degët profesionale, por edhe për projekte madhore artistike, kulturore e sociale.

"ACE" u krijua me profesionistë që aspirojnë në fushat e projektimit, komunikimit dhe arteve, të cilët vijnë nga fushat e mjeshtërive së zëjtarsisë shqiptare, akademikë të fushës, për programet që ndërmerren brenda qendrës; eksperiencia kombëtare dhe ndërkombëtare; një imazh dhe një marketing i ri, për të rinjtë që do të frekuentojnë kurset në ACE, drejt krijimit të biznesit të tyre. Me RisiAlbania filloi një bashkëpunim që në vitin e parë të themelimit të shkollës Albania Craftsman Education ACE. Për sistemin e ri "Blending" që ACE solli si risi në Shqipëri, menjëherë pas pandemisë Covid-19, iu desh të trajnonte instruktorët e saj me një sistem të ri të mësimdhënies dhe së bashku me RisiAlbania u ndërmor projekti i trajnimit të trajnerëve për mësimdhënie online dhe fizike të alternuar mes praktikës dhe teorisë. Ky projekt pasoi në vitin e dytë të saj me krijimin e librit profesional fizik dhe digital duke përpunuar platformën online të shkarkimit të librit dhe kurseve online.

Gjithashtu, me mbështetjen e RisiAlbania një nismë e re u ndërmor, për krijimin e tutorialëve praktikë dhe kurseve online që studentët të shkarkonin direkt nga platforma www.craftsman.al.

"Jemi në vitin e pestë të bashkëpunimit me RisiAlbania dhe në këto 5 vjet sollëm vetëm rezultate, jo vetëm shifrore mbi benefitet financiare por, mundësua mundësi më të mira punësimi për familje dhe komunitete të marginalizuara", tregon Mimi.

Në vijimësi të krijimit të një gjenerate të re instruktorësh profesionistë për kurse online, ACE trajnoi 25 instruktorë të rinj në disa fusha të ndryshme, të cilët ju bashkangjiten krijimit të kurseve profesionale duke sjellë teknika dhe tutoriale praktike profesionale në lëndën e tyre dhe duke mundësuar qasjen e qindra personave të interesuar nga fillestarë ose mbi avancimin e teknikave pranë bizneseve të ngritura e-commerce apo fizike.

Projekte të tilla sollën zhvillimin dhe përmirësimin e mësimdhënies me sistemet më të mira bashkëkohore dhe të shpejta. Në çdo kurs të përfunduar, ACE shoqëron çdo kurs profesional me një plan biznesi, investim dhe marketing për të sjellë krijime start-up sa më të sigurt dhe të suksesshme.

"Sot mund të përmendim me dhjetëra histori suksesi, të cilat po promovohen nga media të ndryshme dhe institucione të cilat i kanë marrë si model investimi dhe zhvillimi nga më të mirat në vend. Vetëm në vitin 2023 numërohen mbi 120 biznese të krijuara nga studentët që u aftësuan në ACE përgjatë viteve 2021-2023".

ACE është çdo ditë në kërkim për të përmbushur misionin e saj, për të sjellë risitë e reja, zgjerimin e shtrirjes gjeografike me pjesëmarrje të lartë në gjithë vendin dhe jashtë saj. Mësimi, ACE është listuar në projekte të ndryshme Bashkimit Evropian mbi shkëmbimin e të rinjve, eksperiencave, trendeve të fundit digjitale të mësimi, ekonominë e gjelbër dhe shkëmbimin kulturor arsimor të lektorëve të saj.

